



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.326/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve: S.Sh., R.Sh. dhe M.B., për shkak të veprës penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe J.B., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve, M.B. dhe S.Sh., kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.156/2019 të datës 26.02.2020 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.410/2020 të datës 12.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16 dhjetor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve M.B. dhe S.Sh. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.156/2019 të datës 26.02.2020 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.410/2020 të datës 12.10.2020.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.156/2019 të datës 26.02.2020, i ka shpallur fajtor të dënuarit: S.Sh., R.Sh. dhe M.B., për shkak të veprës penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe J.B., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe i ka gjykuar: të dënuarin S.Sh., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 16.01.2019 deri me datë 26.03.2019, të dënuarin R.Sh., me dënim me kusht burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) €, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, të dënuarin M.B., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 600 (gjashtëqind) €, si dhe të dënuarin J.B., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) €. Të dënuarit janë obliguar në pagesën prej 30 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 30€, në fondin e kompensimit të viktimave.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.410/2020 të datës 12.10.2020, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve S.Sh. dhe M.B. dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit M.B. av. Sh.Sh. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit S.Sh. av. G.K. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të

bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të merr aktgjykim duke pasur parasysh llojin e shkeljes.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresat KMLP.II.nr.179/2020 e datës 24.11.2020 dhe KMLP.II.nr.326/2020 e datës 14.12.2020, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit M.B., thekson se në rastin konkret i dënuari ka mohuar kryerjen e veprës penale por për shkak të faktit se është njeri laik, i paarsimuar dhe ka qenë hera e parë që ka qenë i akuzuar i njëjti nuk e ka ditur se për çka është i akuzuar. Deklarimi i tij në gjykatë se nuk ka nevojë për mbrojtës e ka bërë nga fakti se nuk ka pasur mundësi që të angazhoj mbrojtës për shkak të gjendjes së varfër ekonomike, andaj i njëjti është shpallur fajtor dhe është dënuar duke mos e ditur se për çfarë vepre penale bëhet fjalë edhe pse i dënuari M.B. e ka pranuar faktin se lopën e tij të vetme ia ka shitur të dënuarit tjetër S.Sh. nga fakti se bashkëshorten e ka pasur të sëmurë dhe nuk ka pasur të holla për dërgimin e saj te mjeku dhe blerjen e medikamenteve për shërimin e saj. Po ashtu i dënuari ka pohuar faktin se lopën të cilin ia ka shitur të dënuarit S.Sh. disa muaj më parë e ka kontrolluar tek veterineri për shkak se nuk kishte ngrënë por pasi që i ka blerë disa vitamina veterineri i kishte thënë se nuk ka kurrfarë sëmundje dhe lirisht mundesh me prerë dhe konsumuar mishin e saj.

Pretendohet se duke u bazuar në këto nuk ka vend kualifikimi i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se mish i lopës së tij ishte gjetur në lokalin e të dënuarit tjetër S.Sh., përkatësisht ky mish ka qenë i vjerrur në grepa dhe larg mishit tjetër të dyshuar nga inspektorët dhe policia dhe se mish i kësaj lope nuk ka qenë i përzier me mishin tjetër që është gjendur tek i dënuari tjetër S.Sh.

Mbrojtësi i të dënuarit S.Sh. në kërkesën e tij thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të dispozitës së nenit 384 par.1.9 të KPPK-së, pasi që dënuari kishte bërë pranimin e fajësisë duke menduar se pranimin e fajësisë po e bën vetëm për faktin se ka blerë lopën nga i dënuari tjetër M.B. dhe faktin se këtë lopë e kishte prerë në kushte jo të

përshtatshme, pa dokumentacion përkatës veterinar dhe i bindur se lopa ka qenë në gjendje të mirë dhe në asnjë rrethanë nuk ka bërë pranimin e fajësisë se lopa e prerë ka qenë e sëmurë.

Më tutje pretendohet se dispozitivi i aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqartë me arsyetimin, pasi që arsyetimi është në kundërshtim të plotë me vetveten. Deri sa në dispozitiv është përshkruar se i dënuari me qëllim të shitjes ka vënë në qarkullim artikuj të dëmshëm ushqimor, për të cilët kanë qenë në dijeni se janë të dëmshëm për shëndetin e njerëzve. Kjo është në kundërshtim të plotë me kualifikimin ligjor të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar përkatësisht për veprën penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

kërkesat nuk janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve M.B. dhe S.Sh., janë të pabazuara, ngase aktgjyqimet kundër të cilave kanë parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit M.B. është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari në të gjitha fazat e procedurës penale është njoftuar për veprën penale dhe të drejtën e tij për të pasur mbrojtës dhe atë që nga hetimet e zhvilluara nga ana e prokurorit të shtetit. Bazuar në procesverbalin e marrjes në pyetje të të pandehurit të datës 25.01.2019, ku i dënuari është njoftuar përkitazi me të drejtat e tij sipas dispozitave të neneve 125 dhe 152 të KPPK-së dhe me këtë rast i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e lexuara dhe mbrojtjen do ta paraqes personalisht. Po ashtu edhe gjatë procedurës gjyqësore gjatë shqyrtimit fillestar përkatësisht në faqen e dytë të procesverbalit të datës 23.05.2019 dhe faqen e tretë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor del se i dënuari është njoftuar për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, por edhe për të drejtën në mbrojtës. Për më tepër, i dënuari në të dy këto

shqyrtime gjyqësore ka deklaruar se e ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës dhe faktin se mundet të angazhoj mbrojtës por se nuk e ka parë të nevojshëm angazhimin e mbrojtësit.

Në këtë mënyrë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke u bazuar në kualifikimin ligjor të veprës penale në rastin konkret del se nuk janë plotësuar kushtet për sigurimin e mbrojtjes së detyruar, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 të KPPK-së, kurse i dënuari nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtës me shpenzime publike, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 58 të KPPK-së, dhe nga kjo del se nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara se në rastin konkret janë cenuar të drejtat e të dënuarit gjatë zhvillimit të procedurës penale, meqë ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor i rregullt dhe në asnjë rrethanë nuk janë cenuar të drejtat e të dënuarit të garantuara me dispozitat e procedurës penale.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit S.Sh., fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin gjyqësor kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar, kurse e rëndësishme është të potencohet fakti se bazuar në faqen e katërt të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor i dënuari kishte kuptuar udhëzimet e dhëna nga kryetari i trupit gjykues dhe pastaj ishte deklaruar se e kishte kuptuar përmbajtjen e akuzës dhe pranimin e fajësisë e kishte bërë për këtë përshkrim të dispozitivit të aktakuzës, dhe për më tepër, shqyrtimi gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ishte zhvilluar në prezencë të mbrojtësit të tij G.K. i cili tani në kërkesë e konteston pa të drejtë mënyrën dhe kriteret e pranimit të fajësisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në harmoni të plotë me kualifikimin ligjor të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, meqë në rastin konkret bëhet fjalë për prodhimin e produkteve me qëllim të shitjes përkatësisht mishit të lopës, për të cilin produkt ushqimor kryerësi e ka ditur se është i dëmshëm për shëndetin e njerëzve dhe atë duke u bazuar në faktin se lopa e blerë nga i dënuari tjetër M.B. ishte e sëmurë. Po ashtu këtë fakt duke e ndërlidhur me faktin tjetër se në lokalin ku i dënuari S.Sh. ushtronte veprimtarinë e përpunimit të produkteve të mishit ishte një lokal i papërshtatshëm për ushtrimin e kësaj veprimtarie, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë të dënuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Edhe pse kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e tyre kanë dominuar pretendimet përkitazi me konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.326/2020, më 16 dhjetor 2020

B.profesionale,
Minire Xhambazi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka